



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:056050

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05842197

PKR.nr.99/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga Kryetarja e trupit gjykues - gjyqtarja Alltën Murseli, me bashkëpunëtoren profesionale Qëndresa Alimehaj Ujkani, në çështjen penale kundër të akuzuarve **G.K** për shkak të veprave penale „Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par 1 të KPRK-se dhe veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par. 2 të KPRK-se i pandehuri **B.S** për shkak se ka kryer veprën penale „Posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, psikotrope apo analoge” nga neni 269 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I.nr. PP/I.nr.35/24 të datës 17.05.2024, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 12.06.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i shtetit Dulina Hamiti, të akuzuarve me mbrojtësit e tyre , me datë 12.06.2024 gjykata mori dhe publikisht, shpalli, ndërsa me datë 19.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarve

- G.K** i lindur me datën ... në ..., i biri i K. dhe nënës G. e vajzërisë K. me banim në rrugën „...” nr. ..., ..., i martuar, babi i një femiju, në studente në fakulteti e A... në drejtimin IT, me profesion taksist, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar me numër personal #... lëshuar nga MPB, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, posedues i numrit të telefonit ...
- B.S** i lindur me datën ... në ... i biri i M. dhe nënës L. e vajzërisë R. me banim Rr. ... Nr. 16 komuna ..., beqar, ka të kryer fakultetin e edukatës fizike, i pa pune, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal ... lëshuar nga MPB, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, posedues i numrit të telefonit

JANË FAJTORË

S e p s e: I pandehuri G.K ;

Me datën 16.2.2024 rreth orës 20:30, në rrugën „...” përkatësisht në lagjen ... në Prishtinë me dashje e pa autorizim shet substance narkotike te llojit Kokainë në atë mënyrë që Policia e DTHN gjatë patrullimit në lokacionin e lartcekur vërejnë te pandehurin G. dhe te pandehurin B. duke shkëmbyer diçka mes vete, me c’rast te njëjtit ndalohen dhe me rastin e kontrollit trupor tek i pandehuri G. gjejnë një qese te mbushur me bari ngjyre e gjelbër e dyshuar si marihuane me peshe prej 1.9gr, kurse tek i pandehuri B. gjejnë një qese te mbushur me pluhur te bardh e dyshuar si narkotik i llojit kokainë me peshe prej 0.7gr te cilën i pandehuri B.e pranon se e kishte ble për konsumim personal nga i pandehuri G. në vlere prej 45€, e cila shumë e parave edhe i gjinden te pandehurit G. në trup, ku edhe behet sekuestrimi i substancës narkotike dhe shumes se parave, dhe substanca e lartcekur pas ekzaminimit rezulton narkotik i llojit marihuane me peshe neto prej 1.31gram dhe kokaine me peshe neto prej 0.67gram,

- me çka ka kryer veprën penale **„Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge”** nga neni 267 par 1 të KPRK-së

II. Më parë e në vazhdimësi deri me datën 16.2.2024 rreth orës 20:45, në rrugën „...” përkatësisht në lagjen ... në Prishtinë me dashje e pa autorizim me qëllim të shitjes posedon dhe ofron për shitje substancë narkotike te llojit marihuane dhe kokaine në atë mënyrë që pas veprimeve nga dispozitivi i parë, policia me pëlqimin e te pandehurit G.zbatojnë kontroll në banesën e tij gjejnë një qese te mbushur me pluhur te bardh i dyshuar si narkotik i llojit Kokainë me peshe prej 0.7gr, 4 paketime me bari ngjyre e gjelbër e dyshuar si narkotik i llojit marihuane me peshe prej 5.9gr, një vazo e mbushur me bari ngjyre e gjelbër e dyshuar si narkotik i llojit marihuane me peshe prej 38.1gr, një qese e mbushur me bari ngjyre e gjelbër e dyshuar si narkotik i llojit marihuane me peshe prej 13.5gr, një qese e mbushur me bari ngjyre e gjelbër e dyshuar si narkotik i llojit marihuane me peshe prej 5.3gr, një peshore digjitale, qese te thata dhe folje qe shërbejnë për paketim te narkotikut, te cilat edhe sekuestrohen nga ana e Policisë, e cila me rastin e ekzaminimit rezulton narkotik i llojit marihuane me peshe te përgjithshme prej 46.44gr dhe kokaine me peshe prej 0.7gram,

- me çka ka kryer veprën penale **„Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge”** nga neni 267 par 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së

I pandehuri B.S;

III. Me datën 16.2.2024 rreth orës 20:30, në rrugën „,,” përkatësisht në lagjen ... në Prishtinë me dashje e pa autorizim ka poseduar narkotikë, substanca psikotrope apo analoge të llojit kokaine në peshë prej 0.7gr në atë mënyrë që i pandehuri natën kritike shkon tek i banesa e te pandehurit G. ku ne shumën prej 45€ blen për konsumim personal narkotike te llojit kokaine ne sasi prej 0.7gr, me c’rast i njëjti vërehet nga ana e Policisë dhe me rastin e ndalimit dhe kontrollit trupor tek i njëjti gjendet dhe sekuestrohet substanca narkotike, e cila pas ekzaminimit rezulton narkotik i llojit kokaine me peshe prej 0.46gram.

- me çka ka kryer veprën penale „**Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope apo analoge**” nga neni 269 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së,

Prandaj gjykata në bazë të neneve: 4,7,17 38; 42; 43; 69; 70,72 dhe 267, 269 të KPRK-së si dhe nenit 364, të KPPRK-së të akuzuarve u shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Të akuzuarit **G.K** per veprën penale si ne piken I te dispozitivit te aktakuzes „**Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge**” nga neni 267 par 1 të KPRK-së i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 500 euro dhe denim me burgim ne kohëzgjatje prej tetë (8) muaj .

Të akuzuarit **G.K** per vepren penale si ne piken II te aktakuzes **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge**” nga neni 267 par 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së i shqipton deni me gjobe ne shume prej 500 euro dhe denimme burgim ne kohezgjatje prej 12 muaj.

Ne bazë të nenit 76 par.2 , nën par 2.2 të KPRK-së, te akuzuarit **G.K** i shqiptohet dënimi unik me burg në kohëzgjatje prej 1 vit e 6 muaj si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1000 euro.

Dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari **G.K** mund ta paguajnë deri në tre (3) këste mujore në afat kohor prej tre (3) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Konform nenit 79 të KPRK-së, të akuzuarit **G.K**, në dënimin me burgim të shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 16.02.2024 deri më datë 13.05.2024, ndërsa në masën e arrestit shtëpiak nga data 13.05.2024 deri me datë 12.06.2024.

Te akuzuarit B.S për veprën penale si në piken III të aktakuzës **Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope apo analoge**” nga neni 269 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së, i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 500 euro.

Dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari B.S mund ta paguaj deri në dy (2) këste mujore në afat kohor prej dy (2) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi

Në rast se te akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë të shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.

Obligohen që të akuzuarit t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe atë; në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej pesedhete (50) euro secili veç e veç në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Te akuzuarit **G.K** konform nenit 267 par.5 të KPRK-së, i konfiskohet substanca **narkotike e llojit marihuanë me peshë neto prej 46.44gram dhe kokainë me peshë neto prej 0.67gr të sekuestruara** dhe konform nenit 276 të KPRK-së, **te hollat ne shumë prej 45 euro.**

Te akuzuarit **B.S** konform nenit 269 par.3 i konfiskohet **substanca narkotike e llojit kokainë me peshë neto prej 0.46gr e sekuestruar.**

ARSYETIMI

Prokuroria Themelore Departamenti për Krime të Renda në Prishtinë me datën 17.05.2024 ka parashtruar aktakuz kundër te pandehurve **G.K** për shkak se ka kryer veprat penale „Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par 1 te KPRK-se dhe vepres penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së si dhe i pandehuri **B.S** për shkak se ka kryer veprën penale „Posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, psikotrope apo analoge” nga neni 269 i KPRK-së.

Së bashku me aktakuzën, prokuroria ka dorëzuar edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë PP/L.nr.35/2024, të datës 20.05.2024 të lidhur në mes të Kryeprokurorit te Prokurorisë Themelore në Prishtinë Zejnullah Gashi dhe prokurorit të shtetit Arben Hoti në një të njëjtën anë dhe të akuzuarit me mbrojtësin e tyre, në anën tjetër, marrëveshje e cila është vendosur në shkresat e lëndës PKR.nr.99/2024, pas pranimi të saj nga gjykata, pasi më parë të akuzuarit si më lart kanë pranuar fajësinë për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas leximit të dispozitivit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe janë deklaruar fajtorë për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe kanë shtuar se janë të vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit.

Sa i përket pranimi të fajësisë nga të akuzuarit, Prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetëm në tersi pranë marrëveshjeve për pranimin e fajësisë dhe i propozoj gjykatës që të njëjtën ta pranoj ashtu siç është lidhur në mes të prokurorisë dhe të akuzuarve dhe i propozoj gjykatës te aprovji marrëveshjen per pranimine fajesisi per te akuzarit G.K dhe B.S. Gjithashtu mbetemi pranë dënimeve të propozuara në marrëveshje per pranim te fajësis te datës 13.05.2024,

Mbrojtësi i të akuzuarit **G.K**, av. Liridon Kutllavci, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, aq më tepër kur me datë 20.05.2024, është lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë pranë të cilës mbeten edhe sot dhe propozojnë që të njëjtën

ta aprovoj gjykata. dhe se e njëjta është lidhur ne pajtimi me dispozitën e nenit 233 te KPrk-se. Si dhe mbetemi pranë dënimeve të propozuara në marrëveshje.

I akuzuari **G.K** deklaroi se pajtohem me thëniet e mbrojtësit te tij si dhe pajtohem pranë dënime te propozuare ne marrëveshje duke shtuar se i kërkoji falje gjykatës dhe te gjitha institucioneve dhe premtoji se nuk përsëris asnjëherë këso vepra dhe te keni parasysh se jam mbajtës te familjes 7 anëtarësh si dhe gjate procesi te këtij gjykimi e kam humbur një fëmije se kam kam pasur gruan shtatzënë e lus gjykatën te ketë parasysh këto rrethana

Mbrojtësi i të akuzuarit **B.S** Av. Valentina Shabani ka deklaroi se i propozoj gjykatës qe te aprovoji marrëveshjen mbi pranimin e fajësis pas qe është arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë duke i propozuar gjykatës që në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit me rastin e caktimi të dënimit ta merr parasysh rrethanë lehtësuese pas qe i mbrojturi ime për here pare ka rene ndesh me ligji, ka qene bashkëpunues me organet e drejtësi qe nga fillimi i ndalimit nga ana e polices e deri me tani është i penduar për veprimet e tij ndihet fajtor dhe premtion se nuk do te kryej vepra penale te njëjtin apo te ngjashme penale prandaj i propozoji gjykatës qe te ketë parasysh këto rrethane lehtësuese dhe ndaj te njëjtin ti shqiptoji një dënim sa me te bute dhe atë dënim me gjobe konsiderojmë dhe ne si mbrojtore deklarojmë se do te arrihet qëllimi konforme dispozitës ligjore te nenit 38 te kodi penale dhe se mbeten pranë dënimeve të propozuara në marrëveshje, dhe ashtu si deklaromë me lartë ne seancën dëgjimore për pranimin e marrëveshjes se pranimin te fajësi.

I akuzuari Besart Selamani deklaroi; se pajtohem me marrëveshjen e fajësi dhe ndihem i penduar dhe premtoji qe kurr nuk me përsërit ketë vepër penale.

Pas shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nga te akuzuarit me mbrojtësin e tyre në njëjren anë dhe prokurorisë në anën tjetër dhe deklarimit të akuzuarve se ndihen fajtorë për kryerjen e veprave penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kryetarja e trupit gjykues me aktvendim ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë si më lart, si dhe pranimin e fajësisë nga te akuzuarit në shqyrtim fillestar, pasi është bindur se te akuzuarit e kane kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, se po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht nga te akuzuarit, pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe duke u mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, e cila nuk përmban shkelje ligjore e as gabime faktike.

Po ashtu, edhe nga provat materiale të cilat ndodhen në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit G.K ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale, „Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par 1 te KPRK-se dhe vepres penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së ndërsa ne veprimet e te akuzuarit B.S ekzistojnë të gjitha elementet e vepres penale Posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, psikotrope apo analoge” nga neni 269 i KPRK-së. si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata i shpalli fajtorë të akuzuarit, pasi që më parë gjeti se jane penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që, ndaj të akuzuarve gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese siç janë: pranimin e fajësisë nga te akuzuarit, sjellja e të akuzuarve para dhe pas kryerjes së veprës penale, keqardhjen e shprehur nga te akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, moshën e tyre të re, si dhe gjendjen e tyre ekonomike, ndërsa si rrethana rënduese mori parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, shkallen e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale.

Andaj, gjykata të akuzuarve iu shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Pasi që të akuzuarit kanë arritur marrëveshje me prokurorinë për pranimin e fajësisë dhe ka pranuar fajësinë edhe në shqyrtim fillestar, duke u bazuar në dispozitat e neneve 72, par. 1, nënpar. 1.3 të KPRK, gjykata ka zbutur dënimin ndaj tyre, duke vlerësuar se edhe me një dënim më të butë se dënimi i paraparë me dispozitat e kodit penal si më lart, mund të arrihet qëllimi i dënimit, e për këtë gjykata ka vlerësuar thëniet në paragrafin si më lart.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një veprë penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi që të akuzuarit t'i mundësohet pagesa e dënimit me gjobë me këste u mor në bazë të nenit 43 par. 2 të KPRK.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me burg në gjobë u mor konform nenit 46 par.1 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453, par. 1, të KPRK-së ndërsa lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 36 par 3, pika 3.2, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 08/L-109).

Nga sa u tha më lart dhe në bazë të neneve 230 par.20 të KPRK-së dhe 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.99/24 datë 19.06.2024**

B.profesionale
Qëndresa Alimehaj Ujkani

Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,
Alltën Murseli

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.